

BANKA E SHQIPËRISË

**PËRSE DUHET TË KENI
NJË BUXHET
PERSONAL?**



KËTË PUBLIKIM MUND TA GJENI EDHE NË FORMË ELEKTRONIKE NË ADRESËN:

WWW.BANKOFALBANIA.ORG

NË QOFTË SE DËSHIRONI TË KENI KOPJE TË SHKRUARA TË TIJ MUND T'Ë KËRKONI NË ADRESËN:

BANKA E SHQIPËRISË, SHESHI "SKËNDERBEJ" NR.1 TIRANË, SHQIPËRI,

TEL.: +355-(0)4-222152;

FAKS: +355-(0)4-223558

OSE DUKE DËRGUAR NJË E-MAIL NË ADRESËN:

PUBLIC@BANKOFALBANIA.ORG

TIRAZHI: 6000 KOPJE

PËRMBAJTJA


PËRSE LIND NEVOJA PËR NJË BUXHET PERSONAL?	10
TË MIRAT E BUXHETIT	11
HAPAT E NDËRTIMIT TË BUXHETIT	15
CILI ËSHTË BURIMI I TË ARDHURAVE DHE SA JANË ATO?	19
SA DUHET TË SHPENZOJË AI PËR TË PATUR NJË JETESË NORMALE?	20
SI MUND TË QËNDRONI BESNIK NDAJ BUXHETIT?	25

Për këdo është e pamundur të fillojë të
mësojë diçka që ai mendon se e di.
Epiktetus, rreth 60 p.k.

PËRSE DUHET TË KENI NJË

BUXHET PERSONAL?

Shumë njerëz nuk janë plotësisht të bindur që kanë nevojë për një buxhet. Mënyra se si ata arsyetojnë është diçka e tillë: “Ajo që praktikisht më duhet të bëj është të shpenzoj më pak se sa fitoj. Atëherë përse më duhet një buxhet?”. Në qoftë se kjo ngjan me diçka që edhe ju mendoni, pikërisht ju keni më tepër nevojë për të mbajtur një buxhet. Të tjerë njerëz e ndjejnë nevojën e buxhetit por nuk dinë nga t’ia fillojnë.



Megjithëse disa njerëz e shohin të nevojshme të krijojnë një buxhet personal, ekzistojnë të tjerë të cilët thjesht nuk kanë dëshirë të kufizojnë shpenzimet e tyre. Shumë njerëz kryejnë blerje emocionale dhe të pamenduara mirë. Në mënyrë që kjo të shmanget, njerëzit duhet të jenë më të përgjegjshëm me shpenzimet e tyre. Një prej mënyrave më të mira për të ndihmuar dikë të arrijë këtë qëllim është **buxheti personal**. Buxheti personal përfshin një strukturë të detajuar të të ardhurave dhe të shpenzimeve tuaja, e cila tregon gjendjen reale të situatës tuaj financiare.

PËRSE DUHET TË KENI NJË



Një fjalë e mençur e popullit thotë “Nuk është e domosdoshme të jesh pulë për të nuhatur një vezë të prishur!”. Kësisoj, nuk është e domosdoshme që të jesh një ekonomist për të ndërtuar një buxhet. Në qoftë se dëshironi të kuptoni nëse jeni në rrugën e duhur për të arritur qëllimet tuaja financiare, ndiqni me kujdes shpjegimet e mëposhtme.



PAK HISTORI MBI BUXHETIN



Përpara se të shpjegojmë buxhetin si koncept ekonomik të ditëve të sotme, le të hedhim një vështrim mbi origjinën e kësaj fjale. Fjala buxhet e ka prejardhjen nga fjala frëngjisht buzhet (*bougette*), e cila rrjedh nga fjala buz (boug), që do të thotë një çantë lëkure. Sipas këtij shpjegimi fjala në shqip buxhet, nënkupton një çantë të vogël lëkure. Në mesjetë, përpara asamblesë angleze prezantoheshin disa letra, të cilat përmbanin informacion rreth taksave dhe shpenzimeve. Këto letra futeshin në çanta të vogla lëkure (*bougette*) të cilat vendoseshin mbi një tavolinë përpara asamblesë. Me kalimin e shekujve, kjo fjalë filloi të përdorej sipas kuptimit të vetë çantës, megjithëse fillimisht tregonte vetëm një grup sendesh. Ndërsa përkufizimi i sotëm i fjalës buxhet nënkupton “një parashikim të specifikuar të shpenzimeve të një personi ose të një kompanie, që priten të kryhen në një periudhë kohe të përcaktuar”.

PËRSE DUHET TË KENI NJË

PËRSE LIND NEVOJA PËR NJË BUXHET PERSONAL?

Buxheti mund të konsiderohet si hapi i parë për të arritur qëllimet tuaja financiare. Ai ju ndihmon të kontrolloni shpenzimet tuaja, duke krijuar mundësi që të shtoni kursimet. Në një farë mënyre buxheti është ndërgjegjja juaj financiare. Ai tregon se sa fitoni dhe sa jeni duke shpenzuar.

Për shumë njerëz buxheti është diçka shumë e vështirë për t'u mbajtur dhe për t'i qëndruar besnik. Pikërisht, ata që kanë një mendim të tillë për buxhetin e kanë tepër të nevojshme të kenë një të tillë. Mungesa e entuziazmit të mbajtjes së një buxheti, zakonisht nënkupton mospëlqimin e rezultateve që ai mund t'ju tregojë.



BUXHET PERSONAL?

TË MIRAT E BUXHETIT

Po cilat janë të mirat që na sjell buxheti?
Sigurisht që përgjigjja e kësaj pyetjeje është e ndryshme për çdo individ, por më poshtë mund të gjeni disa prej avantazheve që njerëzit vënë re kur fillojnë të mbajnë një buxhet:

njohje

- Jeni gjithmonë në dijeni të gjendjes tuaj financiare. Buxheti personal ju jep mundësinë të dini me saktësi se sa të ardhura keni. Për më tepër, ai është një mënyrë për të edukuar veten tuaj dhe ju tregon se si kategorizohen të ardhurat tuaja, a ju mjaftojnë ato dhe sa kohë ju duhet për të arritur qëllimet tuaja.

PËRSE DUHET TË KENI NJË

- Ju mund të kontrolloni më mirë financat tuaja. Pasi të jeni njohur me buxhetin, ju do të jeni në gjendje të dini më mirë se çfarë ndodh me fitimet tuaja. Shpesh fitimi i të ardhurave është i vështirë ndërsa shpenzimi i tyre është gjëja më e lehtë. Kështu, mbajtja e një buxheti personal ju jep mundësinë që të kontrolloni paratë tuaja në vend që të ndodhë e kundërta.
- Ju mund të jeni më të organizuar. Edhe pse mund të jetë i formave më të thjeshta, buxheti i sistemon ose i organizon të ardhurat tuaja në disa kategori shpenzimesh dhe kursimesh. Përveç kësaj, buxheti mund të ofrojë më tepër organizim pasi siguron të dhëna për të gjitha veprimet tuaja me para.

kontroll

organizim

BUXHET PERSONAL?

komunikim

- Ju mund të përmirësoni aftësitë tuaja të komunikimit. Në qoftë se jeni i/e martuar, keni një familje ose i ndani paratë me dikë tjetër, të kesh një buxhet, të cilin (të dy ose të gjithë) e keni krijuar së bashku, është një mundësi më shumë për të gjetur gjuhën e përbashkët në lidhje me shpenzimin e parave. Buxheti është një mjet komunikimi nëpërmjet të cilit diskutohet se ku dhe në çfarë duhet të shpenzohen paratë.

përfitim

- Ju mund të përfitoni nga mundësi të favorshme. Duke ditur gjendjen e saktë të situatës tuaj financiare, dhe duke qenë në kontroll të saj, buxheti ju ndihmon të përfitoni nga mundësi që ndoshta po të mos kishit një buxhet mund t'ju humbisnin. Shpesh ju është dashur të mendoni nëse keni mundësi të blini diçka. Në qoftë se keni mbajtur një buxhet personal nuk keni pse t'ia bëni më këtë pyetje vetes.

PËRSE DUHET TË KENI NJË

- Ju jep mundësinë të keni më tepër kohë të lirë: të gjitha veprimet tuaja financiare organizohen automatikisht për çdo lloj pikëpyetjeje që ju mund të keni rreth çështjes se, ku dhe si do t'i shpenzoni të ardhurat. Duke patur këtë lloj informacioni i kurseni kohë vetes.
- Ju jep mundësinë të kurseni dhe të keni më shumë para në xhepat tuaj: e kush nuk do ta dëshironte këtë? Të jeni të sigurtë që buxheti “do të prodhojë” para shtesë për ju. Mund të shmangen shpenzime të panevojshme, pasi ato të identifikohen. Kursimet, edhe ato më të voglat, mund të grumbullohen dhe të vihen në shërbimin tuaj.

kohë e lirë

kursim

BUXHET PERSONAL?

HAPAT E NDËRTIMIT TË BUXHETIT:

Përpara se të shohim etapat e ndërtimit të një buxheti, le të përmendim disa karakteristika që duhen mbajtur parasysh në çdo hap të formimit të tij. Këto janë karakteristika që çdo buxhet i mirë duhet t'i ketë.

elastik

- Buxheti duhet të jetë elastik. Meqënëse disa prej shpenzimeve tuaja mund të ndryshojnë me kalimin e kohës, atëherë edhe buxheti duhet t'i reflektojë dhe të ndryshojë së bashku me ato.

i thjeshtë

- Buxheti duhet të jetë i thjeshtë. Buxheti nuk duhet menduar si diçka tepër e komplikuar që vetëm ekonomistët mund ta bëjnë. Ai duhet të paraqitet sa më i lehtë dhe duhet parë si diçka argëtuese.

realist

- Buxheti duhet të reflektojë realitetin e të ardhurave dhe shpenzimeve tuaja. Duhet të jeni sa më realistë për sa i përket shpenzimeve tuaja dhe në qoftë se doni të kurseni, duhet të hiqni dorë nga ato shpenzime që duket se janë të tepërta.

PËRSE DUHET TË KENI NJË

Gjëja e parë që duhet bërë kur vendosni të mbani një buxhet është të llogarisni se sa të ardhura arrini të siguroni në një muaj. Për të llogaritur këto të ardhura ju duhet të mendoni të gjitha burimet e tyre, qofshin këto të qëndrueshme apo të rastit. Pasi keni llogaritur të ardhurat tuaja mujore, hapi i dytë që duhet të ndërmerri është të llogarisni shpenzimet tuaja. Mbani parasysh të jeni sa më realistë në këtë paraqitje. Lënia mënjanë e disa shpenzimeve apo “mbyllja e syve” ndaj disa të tjerave, nuk do të mashtrojnë askënd tjetër përveç vetes tuaj. Më e mira do të ishte paraqitja e shpenzimeve në dy kategori, në shpenzime të domosdoshme dhe jo të domosdoshme.

Kjo ju jep mundësinë të planifikoni ato shpenzime që janë shumë të rëndësishme për të siguruar një jetesë normale dhe gjithashtu, të kontrolloni disa prej shpenzimeve tuaja jo aq të domosdoshme (për shembull argëtimin).



BUXHET PERSONAL?

Sigurisht që shumë prej shpenzimeve tuaja nuk jeni në gjendje t'i kontrolloni (për shembull, qiranë e shtëpisë).

Megjithatë, edhe pse nuk jeni në gjendje ta bëni diçka të tillë, ju gjithmonë mund të kërkonit mënyra për të minimizuar këto shpenzime (për shembull, ta ndani apartamentin me dikë tjetër). Kështu, duhet të gjeni gjithmonë një zgjidhje për të arritur një kontroll financiar sa më të mirë për shpenzimet tuaja.

Siç përmendëm më lart ekzistojnë dy kategori shpenzimesh. Së pari, janë shpenzimet e domosdoshme mujore – ato të cilat ju i kryeni çdo muaj.

Së dyti, janë edhe shpenzimet jo të domosdoshme – ato që ju i kryeni në mënyrë të parregullt, të papritur për të cilat paguani nga një deri në disa herë në vit. Edhe pse është e vështirë të parashikohen me saktësi, shpenzimet jo të domosdoshme duhet të jenë pjesë e buxhetit tuaj, në mënyrë që të jeni gjithmonë të përgatitur për këto lloj harxhimesh.

LOGJIKË SE SI MUND T'I PARASHIKONI ATO ËSHTË E THJESHTË:

Mbështetur në eksperiencën e viteve të kaluara, ju mund të bëni një hamendje deri-diku të saktë se sa mund të jetë shuma e shpenzimeve të kësaj natyre. Në qoftë se e keni një hamendje të tillë, nuk ju mbetet gjë tjetër veçse ta ndani atë në muaj.

PËRSE DUHET TË KENI NJË

SI TA BËNI KËTË?

Shumë thjesht, mjaft që të pjesëtoni shumën në total (shuma që planifikohet të shpenzohet për këto raste të veçanta) me 12 (të cilët janë muajt e vitit).

Buxheti

SHEMBULL:

Sic thamë edhe më sipër, të krijosh një buxhet personal nuk është e vështirë. Ai mund të kuptohet edhe nga një nxënës i fillores që di të mbledhë, të zbresë, të shumëzojë apo të pjesëtojë. Buxheti nuk është e thënë të jetë një rrëmujë shifrash të pakuptueshme. Në vazhdim po ju prezantojmë një shembull të thjeshtë se si mund të krijohet një buxhet personal.

A collection of hand-drawn mathematical symbols and numbers in a cursive, sketchy style. The symbols include the numbers 5, 8, 3, 2, 7, 4, 1, and 8. The mathematical operators include addition (+), subtraction (-), multiplication (x), division (÷), and a percentage sign (%). There are also equals signs (=) and a tilde (~) symbol.

BUXHET PERSONAL?

Genti sapo është diplomuar dhe jeton me qira në një nga lagjet e Tiranës. Ai banon vetëm dhe nuk ka njeri tjetër për ta mbështetur financiarisht. Fatmirësisht ai ka gjetur një punë të mirë. Megjithatë, fillimi i kësaj jete të re duket i vështirë për Gentin. Shpenzimet nuk kanë të sosur ndërsa të ardhurat e tij janë fikse. Genti mendon se duhet të marrë situatën në kontroll dhe vendos të mbajë një buxhet personal.

Ja se si vepron ai:

CILI ËSHTË BURIMI I TË ARDHURAVE DHE SA JANË ATO?

Gjëja e parë që Genti bën është llogaritja e të ardhurave të tij mujore që vijnë vetëm nga puna e tij. Në çdo fund muaji, ai tërheq pagën pranë bankës ose ATM-së më të afërt në lagjen e tij. Paga e tij mujore është 50.000 lekë.

PËRSE DUHET TË KENI NJË

SA DUHET TË SHPENZOJË AI PËR TË PATUR NJË JETESË NORMALE?

Në këtë rast Genti mendon një listë të gjërave më të nevojshme që i duhen çdo muaj për të siguruar një jetesë normale. Lista e tij përfshin këta zëra:

SHPENZIME TË DOMOSDOSHME

- 1) Qira
- 2) Energji elektrike
- 3) Ujë
- 4) Ushqime
- 5) Veshmbathje
- 6) Shpenzime për makinën
- 7) Telefon

Po sa kushtojnë të gjitha këto çdo muaj? Përveç qirasë që ka një çmim fiks, tashmë të vendosur në kontratën njëvjeçare me qiradhënësin, zërat e tjerë nuk janë shpenzime fikse. Në varësi të sasisë së konsumuar këto shpenzime mund të ndryshojnë nga njëri muaj në tjetrin.

Qira
Telefon
Energji elektrike
Ujë
Ushqime
Veshmbathje
Shpenzime për makinën

BUXHET PERSONAL?

Çmimet e disa prej zërave të mësipërm nuk varen nga Genti. Për shembull, qeveria vendos rritjen e çmimit të energjisë elektrike apo çmimi i naftës rritet në treg. Këto janë gjëra që Genti nuk mund t'i kontrollojë.

Për t'i patur sa më në kontroll shpenzimet e tij Genti vendos të mbajë shënim çdo shpenzim, për gjithçka që ka blerë (edhe sendet më të vogla). Kjo gjë i jep mundësinë atij të krijojë një ide të qartë se sa i duhet të shpenzojë minimalisht në muaj për gjërat e nevojshme.

Përpara se të fillojë llogaritë, Genti u hedh një sy librezës së energjisë elektrike dhe asaj të ujit. Për fat të mirë i ka paguar të gjithë muajt paraardhës. Ky është një lirim për Gentin. Ja se çfarë tregon lista e tij e re:

SHPENZIME TË DOMOSDOSHME	
1) QIRA	15,000
2) USHQIME	15,000
3) FATURA E KESH	2,200
4) FATURA E UJËSJELLËSIT	500
5) VESHMBATHJE	5,000
6) SHPENZIME PËR MAKINËN	4,000
7) TELEFON	2,000
TOTALI	43,700

PËRSE DUHET TË KENI NJË


Tashmë Genti e di që çdo muaj, ai duhet të lërë mënjanë 43.700 lekë për shpenzimet e domosdoshme. Por, nuk mbaron me kaq. Gjatë muajit ai shpenzon dhe për gjëra të tjera, mbase jo shumë të domosdoshme për të jetuar por të nevojshme për të patur një jetë sociale të pranueshme. Për momentin, Genti i quan shpenzime “jo të domosdoshme”.

LISTA E TYRE VIJON SI MË POSHTË:

1. Argëtim (kjo përfshin kafe, bileta kinemaje ose blerje të vogla).
2. Dhurata (për ditëlindje, dasma apo festa të ndryshme).

Gjatë kohës që Genti bën këtë listë mendon për të gjitha restorantet që ka frekuentuar kohët e fundit dhe vendos të hajë në shtëpi. Kjo do t'i sillte përfitime jo vetëm xhepit por edhe aftësive të tij gatuese. Ai mendon se ka ardhur koha të perfeksionojë mënyrën e gatimit të vezës së skuqur.

Përsa i përket dhuratave ai i hedh një sy kalendarit të tij, ku ka shënuar datat për t'u mbajtur mend. Në varësi të tyre ai vendos dhe shumën që i takon këtij zëri për muajin.



BUXHET PERSONAL?

Pasi i mendon mirë shpenzimet
“jo të domosdoshme” lista e
Gentit rezulton e tillë:

SHPENZIME JO TË DOMOSDOSHME	
ARGËTIM	1,300
DHURATA	1,000
TOTALI	2,300

Kështu, pas grupimit të të ardhurave
dhe të shpenzimeve në një
llogari ato paraqiten të tilla:

TË ARDHURAT	50,000	
SHPENZIME TË DOMOSDOSHME		43,700
SHPENZIME JO TË DOMOSDOSHME		2,300
TOTALI I SHPENZIMEVE		46,000
MBETJE	4,000	

Deri tani lista duket se po ecën mirë për
Gentin, sepse rezulton që pas këtyre
shpenzimeve atij i mbeten 4 mijë lekë.

PËRSE DUHET TË KENI NJË

Një arsye e mirë për të festuar me shokët. Por jo! Genti mendon të shtojë dhe një kategori tjetër në buxhetin e tij, dhe pikërisht zërin **kursime**. Shpejt kjo kategori do bëhet shumë e dashur për të, pasi paratë e kursyera do ta lejojnë Gentin të përfitojë nga ndonjë ofertë e mirë apo dhe për të përballuar ndonjë shpenzim “urgjencë”. Këtij zëri Genti i rezervon shumën 3,500 lekë. Pasi ka kryer të gjitha këto llogaritje, Genti përfiton një shembull të një buxheti financiar, kategoritë e të cilit janë të ardhurat, shpenzimet dhe mbetja.

Të ardhurat (sa merr Genti çdo muaj) - 50.000 lekë.

Sa prej këtyre të ardhurave ai i shpenzon në nevoja të domosdoshme dhe sa në ato “jo të domosdoshme”.

SHPENZIME TË DOMOSDOSHME	
1) QIRA	15,000
2) USHQIME	15,000
3) FATURA E KESH	2,200
4) FATURA E UJËSJELLËSIT	500
5) VESHMBATHJE	5,000
6) SHPENZIME PËR MAKINËN	4,000
7) TELEFON	2,000
8) KURSIME	3,500
TOTALI	47,200

SHPENZIME “JO TË DOMOSDOSHME”	
1) ARGËTIM	1,300
2) DHURATA	1,000
TOTALI	2,300

BUXHET PERSONAL?

Sa shpenzon në total Genti çdo muaj:
 $47,200 + 2,300 = 49,500$ lekë.

Duke bërë një zbritje të shpenzimeve nga të ardhurat, vihet se Gentit i mbeten dhe 500 lekë. Tani Genti i lë shënimet e tij dhe i premtos vetes se do t'i përmbahet me rigorozitet këtij buxheti. Për ta festuar përpjekjen e tij të parë për të mbajtur një buxhet, ai fton për një birrë shokun e tij më të ngushtë.



SI MUND TË QËNDRONI BESNIK NDAJ BUXHETIT?

Me siguri që tani ju duket fare e thjeshtë mbajtja e një buxheti. Por kini parasysh se pasi të ndërtoni një buxhet ju duhet të qëndroni besnik ndaj tij. Vetëm duke respektuar karakteristikat e tij dhe duke e përsosur atë me informacione të reja, ju mund të arrini të jeni vërtet të suksesshëm në kontrollin dhe shpërndarjen më të mirë të financave tuaja.

PËRSE DUHET TË KENI NJË

Për të arritur këtë mbani mend tre gjëra:

- 1) Disiplinë.
- 2) Mblidhni informacion.
- 3) Siguroni mjete.

DISIPLINË:

Tregohuni të rreptë me shpenzimet tuaja që në hapat e parë të buxhetit. Pasi të arrini të krijoni një panoramë të qartë dhe të detajuar të shpenzimeve tuaja, atëherë do ta keni më të lehtë që në buxhetet e ardhshme të jeni më të sigurtë, se ku duhen bërë lëshime dhe ku jo. Gjithsesi, asnjëherë mos e konsideroni buxhetin si një sakrificë por shiheni atë si një mjet për të arritur qëllimet tuaja.

MBLIDHNI INFORMACION:

Buxheti personal duhet të jetë sa më elastik dhe të paraqesë të gjitha ndryshimet që mund të vijnë si në kategorinë e të ardhurave ashtu dhe në atë të shpenzimeve. Për këtë, jini të vëmendshëm ndaj çdo informacioni që prek financat tuaja personale dhe reflektojuni atë në buxhetin tuaj. Ndiqni tregun se çdo të ndodhë me çmimet e mallrave të konsumit, çfarë vendimesh do të marrë qeveria për taksat dhe çdo gjë që ndikon në shpenzimet tuaja.

BUXHET PERSONAL?

SIGURONI MJETET:

Mbajtja e buxhetit personal nuk kërkon programe të sofistikuara kompjuterike. Për mbajtjen e tij mjafton një mendje e mprehtë dhe një regjistër të ardhurash dhe shpenzimesh.

PËRSE DUHET TË KENI NJË
